

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegj i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Dr.sc.Driton Muharremi dhe Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.Z. nga fsh. ... K.Vitisë, për shkak të veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit sipas detyrës zyrtare av. H.L. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PKR.nr.207/2018 datë 01.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 09.01.2019 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit V.Z., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PKR.nr.207/2018 datë 01.10.2018 **vërtetohet.**

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan-departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.207/2018 datë 01.10.2018, të akuzuarin V.Z. e ka shpallur fajtorë për shkak të veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, për çka e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor ti paguaj shumën prej 20 euro, ndërsa shpenzimet e procedurës do të paguhën sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate. Konfiskohet: Zoraki M906B, me nr.serik 000413, si dhe tre fishekë të kalibrit PPU 32 Auto, konform nenit 374. Paragrafi 3 të KPRK-së.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

-Mbrojtësi i të akuzuarit V.Z. av. H.L., për shkak të vendimit lidhur me dënimin e shqiptuar, me propozim që Gjykata Apelit ta aprovoj në tërësi ankesën, aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshoj duke i shqiptuar një dënim me të ulët me gjobë, ose një dënim te kushtëzuar.

- Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.565/2018 të dt. 20.12.2018 ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit V.Z. av. H.L., të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa është e pa bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. As gjendja faktike nuk qe objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase nuk është kontestuar me ankesë, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në frymë të pretendimeve ankimore.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit V.Z. av. H.L. lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesa është e pa bazuar. Në ankesën e mbrojtësit nuk ceket ndonjë rrethanë e re e që do të ndikonte në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit. Mbrojtja në ankesë thekson se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar mjaftueshëm faktin se i akuzuari V.Z. është pa të kaluar kriminale dhe kjo është hera e parë që ai me sjelljet e tija bie ndesh me Kodin Penal. Nuk është çmuar sa duhet nga kjo Gjykatë edhe fakti tjetër me rëndësi se i akuzuari është person i pa punësuar dhe nuk realizon kurrfarë të ardhurash, ndërsa në një gjendje të tillë ekonomike gjendet edhe familja e tij e ngushtë qe do të thotë se i akuzuari nuk do të ketë kurrfarë mundësish materiale që të paguaj gjobën e shqiptuar nga gjykata. Përkundër faktit se i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë pa kurrfarë ndikimi dhe presioni pra në mënyrë vullnetare, gjykata nuk e ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 75 par.1 nën par. 1.3 të KPRK-së ku parashihet zbutja e dënimit me rastin e pranimit të fajësisë. Mbrojtja konsideron se me shqiptimin e këtij dënimi nuk do të arrihet qëllimi i dënimit, nuk është në interes të akuzuarit, sepse ky dënim do të ndikonte negativisht në personalitetin dhe në risocializimin e të dënuarit, duke pasur parasysh rrethanat e pa volitshme ekonomike të tij. Meqë është vepra e parë penale kryer nga ai, përmes një sanksioni më të butë, është dashtë ti ipet edhe një shanse për tu përmirësuar dhe për tu bërë anëtarë i dobishëm i kësaj shoqërie duke i ikur posedimit të armëve të zjarrit, kjo pasi qe veprën penale e ka kryer pa ndonjë qëllim apo motiv të veçante.

Mirëpo, Gjykata e Apelit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese të cilat drejtë i ka vlerësuar Gjykata e shkallës së parë dhe atë pranimin e fajësisë, se është i moshës së re, i njëjti është penduar dhe ka kërkuar falje për kryerjen e kësaj vepre penale dhe i premtos gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tjera penale, ndërsa në mungesë të rrethanave rënduese, vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor, gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimin

nën minimumin e paraparë ligjor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.597/18, më 09.01.2019

Procesmbajtës,
Eroll Gashi

Kryetare e kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi_____

3. Afrim Shala _____